

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**

**FAKULTETI JURIDIK**



**Punimi i diplomës master**

**“ ROLI I AVOKATIT TË POPULLIT NË MBROJTJEN E TË DREJTËS PËR  
MOSDISKRIMINIMIN NË REPUBLIKËN E KOSOVËS ”**

Mentor:  
Prof.dr.Visar MORINA

Kandidati:  
Breentina Qoçaj

Prishtinë 2025

## Hyrje

Institucioni i Avokatit të Popullit paraqet një institucion shumë të rëndësishëm, për krijimin dhe zhvillimin e një shteti sa më demokratik dhe mbrojtjen e vlerave demokratike për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Andaj përmes këtij punimi jemi munduar të bëjmë një pasqyrim më të qartë, gjithëpërfshirës dhe një analizë sipërfaqësore të rolit të këtij institucioni në mbrojtjen e të drejtës për mosdiskriminimin në vendin tonë.

Punimi është i ndarë në katër pjesë:

Në pjesën e parë është përshkruar Avokati i Popullit si institucion duke përfshi përdorimin e termit Ombudsman, zanafillën dhe kuptimin e termit Avokatit i Popullit, përbërjen dhe parimet bazë të veprimtarisë së Institucionit të Avokatit të Popullit, zgjedhjen e Avokatit të Popullit, kompetencat dhe përgjegjësitë e Avokatit të Popullit, pastaj selinë, personelin dhe buxhetin e Avokatit të Popullit. Në këtë pjesë gjithashtu janë trajtuar imuniteti i Avokatit të Popullit, shkarkimi nga funksioni i Avokatit të Popullit dhe përfundimi i funksionit të Avokatit të Popullit.

Në pjesën e dytë fillon të trajtohet fushëveprimtaria e Avokatit të Popullit, si parandalimi i torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese nga Avokati i Popullit, procedurat e shqyrtimit të ankesave/kërkesave nga Avokati i Popullit, refuzimi i ankesave nga Avokati i Popullit, procedura e hetimeve nga Avokati i Popullit dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut nga Avokati i Popullit.

Në pjesën e tretë vazhdohet të trajtohet Institucioni i Avokatit të Popullit si organ i barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi, pastaj gjetjet e Avokatit të Popullit lidhur me diskriminim, brojtja nga diskriminimi mbi bazën e moshës, mbrojtja nga diskriminimi mbi bazën e aftësisë së kufizuar, mbrojtja nga diskriminimi mbi baza gjinore, mbrojtja nga diskriminimi e personave LGBTIQ+, mbrojtja nga diskriminimi mbi baza etnike, mbrojtja e të drejtave të fëmijëve, zbatimi i Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, mbrojtja e të drejtës për arsim, mbrojtja e të drejtës për tretmane shëndetësore dhe mbrojtja e të drejtës për punë.

Në pjesën e katërt janë paraqitur vetëm disa raste, ku Avokati i Popullit i ka trajtuar, duke pranuar ankesa, duke dalur në terren, duke hetuar rastet praktikisht, duke konkluduar dhe nxjerrë raporte me rekomandime drejtuar institucioneve përkatëse sikurse në rastet e dështimit të disa komunave në rindërtimin e shtëpive të shkatrruara gjatë luftës, privimi i lirisë sipas “Urdhërësive Ekzekutive”

me standardet ndërkombëtare të personave të ndryshëm nga ana e KFOR-it dhe UNMIK-ut në Kosovë, si shembull rastin Saramati, trajtimin e ankesave kundër Qendrës Korrektuese Për Femra dhe të Mitur në Lipjan , vëzhgimin e zgjedhjeve lokale për kryetarët e komunave 2013 në Republikën e Kosovës, kontrollet e pa autorizuara të KEDS-it në pronat private dhe hapsirat e banimit, ndikimi i pandemisë COVID-19 në të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës, kërkesa ndaj Bankës Qëndrore të Kosovës për qasje në dokumente zyrtare dhe nivelin e zbatimit të ligjit për përdorimin e gjuhëve në Komuna dhe Gjykata Themelore, raste të trajtuara këto me qëllim të çartësimit të rolit të Avokatit të Popullit për mbrojtjen e të drejtës për mosdiskriminim.

Shfrytëzoj rastin ta falenderoj mentorin tim prof.dr.Visar Morina, për gjithë mbështetjen dhe rekomandimet gjatë realizimit të këtij punimi dhe kolegen time prof. Kimete Berisha për korrekturën letrare me çka më është lehtësuar puna.